



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:131437

Datë: 03.04.2023

Numri i dokumentit: 04148983

**PKR.nr.135/22**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË**-Departamenti për krime të rënda, me Kryetarin e trupit gjykues Shaqë Curri, anëtarët e trupit gjykues Sami Sharaxhiu dhe Violeta Husaj-Rugova, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Selvane Bukleta, në çështjen penale ndaj të pandehurës L.B. për shkak të veprës penale mbajtje në pronësi, kontroll, apo posedim i paautorizuar i armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë-Departamenti për Krime të Rënda PP/I.nr.172/22 të dt. 20.07.2022, pas mbajtjes së seancës publike të shqyrtimit gjyqësor me datë 07.03.2023, në prezencë të Prokurorit të shtetit Agron Galani, të pandehurës L.B. dhe mbrojtëses së saj av. S.T. sipas autorizimit, në të njëjtën ditë bie dhe shpall publikisht, ndërsa me dt.03.04.2023 përpiloi këtë merr këtë:

**A K T G J Y K I M**

E pandehura

**L. B.**, e bija e ....dhe nënës ....., e gjinisë ....., e lindur me dt. ...., në fsh. B., K. P., me vendbanim në fsh. I, K. P., me vendbanim të përkohshëm në Gj., ka të kryer shkollën fillore, me Inj.nr....., amvise, e martuar, e gjendjes së mesme ekonomike, shqiptare, shtetase e R. së Kosovës, mbrohet në liri.

**ËSHTË FAJTORE**

**Për shkak se:**

Me dt. 03.06.2022, rreth orës 16:30, në mënyrë të paautorizuar dhe në kundërshtim dhe shkelje me ligjin e zbatueshëm për armë, neni 22 par.2 dhe 3 të Ligjit mbi Armë, ligji nr. 05L-022, me të cilën është përcaktuar se armën me leje për shenjëtarë mund të barten nga vendbanimi deri në poligon dhe anasjelltas, me leje për lëvizje të autorizuar nga policia e pandehura edhe pse ka

poseduar lejen e armës për shenjëtari, nuk i është përmbajtur këtyre kushteve në atë mënyrë që, me datën e lartcekur në fsh. I., K. D., në pronën e G.B., pasi fillimisht kishte kërkuar nga punëtorët që të ndërprejnë punën dhe të largohen nga aty, ka shkuar në shtëpinë e saj , ku ka marr pistoletën Sarsimlas, modeli ST9, kal.9X9mm, me nr. serik T1102-15AC02115, për të cilën posedonte lejen për shenjëtari me nr. kartele DC142201722725673 dhe me pistoletë në dorë kthehet sërish dhe shkon tek shtëpia e të dëmtuarit G. B. dhe me pistoletën në dorë nisjet në drejtim të tij, me ç'rast i njëjti me të vërejtur armën në dorë të të pandehurës i afrohet të njëjtës dhe ia merr armën nga dora dhe më pas i njofton stacionin policor lidhur me rastin.

-me çka ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll, ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata duke u bazuar në nenin 7,38,39,40,43,69, të KPRK-së, nenit 366 par.1 dhe 366 par. 3 të KPRK-së, si dhe nenit 364 të KPRK-së, të pandehurën e:

## **G J Y K O N**

Dënim me gjobë në shumë prej 500 (pesëqind )euro e të cilin dënim është e obliguar që ta paguaj në afat prej 60 (gjashtdhjetë) ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nëse e pandehura e lartcekur dënimin me gjobë nuk e paguan në afat të caktuar, atëherë dënimi me gjobë, gjykata do ta zëvendësoi me dënim burgu, duke llogaritur një ditë burgim për çdo 20 euro të gjobës.

E pandehura obligohet që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor , të paguaj shumën prej 50 (pesëdhjetë) euro, në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

E pandehura obligohet që në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit, të paguaj shumën, prej 50 (pesëdhjetë) euro, në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Të pandehurës i konfiskohet një pistoletë Sarsimlas, modeli ST9, kal.9X9mm, me nr. serik T1102-15AC02115.

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti për krime të rënda ka ngrit aktakuzë PP/I.nr.172/22 të dt. 20.07.2022, ndaj të pandehurës L.B. për shkak të veprës penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par. 2 të KPRK-së.

Me dt.07.03.2023, është mbajtur seanca e shqyrtimit gjyqësor ku prezent ishin, Prokurori i shtetit, Agron Galani, e pandehura L.B. dhe mbrojtësja e saj av. S. T. sipas autorizimit.

Gjykata konform dispozitave të nenit 319 par. 1 dhe 2 të KPP-së, i ka udhëzuar të pandehurën me të drejtat e saj ku në këtë rast e pandehura ka deklaruar, se i ka kuptuar këto të drejta, dhe për mbrojtës ka angazhuar av. S. T. sipas autorizimit.

Para leximit të aktakuzës prokurori i shtetit ka deklaruar se bazuar në aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës PML.nr. 471/22, dt. 13.01.2023, me të cilën është paraparë që dispozita e nenit 367 par.2 të KPRK-së, sipas së cilës dispozitë edhe është ngrit aktakuza, inkriminon vetëm rastet e përdorimit të armës, në mënyrë kërcënuese dhe frikësuese, gjersa kur i akuzuari nuk ka shkrepur fare me armën e tij dhe përdorimi i armës konsiderohet vetëm shkrepja me armë me qëllim të kërcënimit apo frikësimit, e jo ekspozimi i saj si në rastin konkret, për çka edhe bëjë ka bërë përmirësimin dhe ri cilësimin e aktakuzës ashtu si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

Pas leximit të aktakuzës se ri kualifikuar nga prokurori i shtetit, kryetari i trupit gjykues, pasi që është bindur se e pandehura e ka kuptuar aktakuzën, i është dhënë mundësia të pandehurës që të deklarohet për pranimin ose mospranimin e fajësisë, duke e njoftuar për rëndësinë dhe pasojat e pranimin të fajësisë.

E pandehura ka deklaruar se pas konsultimit me mbrojtësen e saj e pranon fajësinë për veprën penale nga neni 366 par.1 të KPRK-së, ndihet e penduar, premtan se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra tjera penale.

Mbrojtësi i të pandehurës, ka deklaruar se meqenëse u bë rikualifikimi i veprës penale dhe pas konsultimit me të mbrojturën e saj, pajtohet në tërësi për pranimin e veprës penale dhe konsideron se e njëjta e ka bërë në mënyrë vullnetare, pa ndonjë presion apo ndonjë shtytje tjetër.

Prokurori i shtetit, ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurës, meqenëse ky pranim është bërë në mënyrë vullnetare dhe pas paralajmërimit me pasojat dhe përparësitë e pranimin të fajësisë, pas konsultimit me mbrojtësen e saj dhe meqenëse është në përputhje me të gjitha provat që gjenden në shkresat e lëndës, propozon që të aprovohet pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurës.

Duke pasur parasysh të lartcekurat gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurës dhe ka vërtetuar se nuk ekziston ndonjë rrethanë për hudhje të aktakuzës dhe se janë plotësuar kushtet nga neni 322 lidhur me nenin 242 të KPPK-së, atëherë gjykata ka vazhduar me fjalën përfundimtare të palëve dhe me shqiptimin e dënimit.

Prokurori i shtetit Agron Galani, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se duke pas parasysh se e pandehura e pranoi fajësinë, propozon gjykatës që me rastin e marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit, si rrethana lehtësuese të ketë parasysh se e njëjta është nënë e 6 fëmijëve, se jeton nga pensioni invalidor, pranimin e fajësisë, pendimin e shprehur për veprën e kryer penale, gjersa si rrethanë rënduese të ketë parasysh mënyrën e kryerjes së veprës penale.

Mbrojtësja e të pandehurës, av. S. T., në fjalën përfundimtare ka deklaruar se meqenëse e mbrojtura e saj e ka bërë pranimin e fajësisë, konsideron se pranimi i fajësisë është një nga

elementet që mundëson për lehtësimin, apo për pranimin e veprës për të cilën e ka kryer, gjithashtu e njëjta është nënë, është me probleme të shumta shëndetësore, ka në çështjen shëndetësore të saj invaliditet të përhershëm, e njëjta nuk ka të drejtë të udhëtojë pa përcjellje, andaj duke marr parasysh të gjitha këto rrethana, gjykatës i propozon që ti shqiptojë një dënim sa më të ulët, që parasheh ligji.

E pandehura L. B., në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështet në tërësi fjalën e mbrojtëses së saj, premtan se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra tjera penale.

Kryetari i trupit gjykues, është i bindur, se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurës është bërë, pasi që e pandehura e kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, dhe pranimi i fajit mbështetet edhe në faktet e çështjes dhe provat në të cilat edhe mbështet aktakuza siç janë: shënimi zyrtar policor i dt. 03.06.2022, i përpiluar nga hetuesi Valdet Ismajlaj, raporti i oficerit Selim Berisha, deklarata e të pandehurës L.B. e dhënë në stacionin policor me dt. 03.06.2022 dhe në prokurori me dt. 13.07.2022, deklarata e dëshmitarit F. K. e dhënë në stacionin policor me dt. 03.06.2022, deklarata e dëshmitarit F. K. e dt. 03.06.2022 e dhënë në polici dhe në prokurori me dt. 29.06.2022, lista e dëshmimeve nga Njësia e Forenzikës Lista e armëve të konfiskuara, fotoalbumi si dhe shkresat tjera të lëndës, pastaj aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore, ose gabim faktik, prandaj gjykata konform 322 lidhur me nenin 242 par 6 të KPP-së, ka pranuar pranimin e fajësisë nga e pandehura.

Me provat e ofruara, si dhe pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurës është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të aktgjykimit. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurës L. B. qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll, ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Gjykata nuk gjeti rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të pandehurës dhe e njëjta është penalisht përgjegjëse.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 69 par.1 të KPRK-së. Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurën gjykata mori, pranimin e fajësisë, shprehjen e pendimit për veprën e kryer, premtimin se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra tjera penale, gjendjes shëndetësore të saj me invaliditet të përhershëm, ndërsa rrethana rënduese për të pandehurën gjykata nuk gjeti.

Sipas bindjes së gjyqtarit, dënimi i shqiptuar, duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurës. Kryetari i trupit gjykues, gjithashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 38 i KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurës nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e saj, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Duke u bazuar ne nenin 449 par. 1 dhe 2 nën par. 2.6 të KPP-se, gjykata ka përcaktuar paushallin gjyqësor në shumë prej 50 euro, duke u bazuar ne shpenzimet që janë shkaktuar nga fillimi i kësaj procedure e deri ne përfundimin e saj.

Konform nenit 36 par.1, 2, 3, nënpar.3.2 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit e obligoi te pandehurën në pagesën e taksë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Konform nenit 366 par.3 të KPRK-së konfiskohet një pistoletë Sarsimlas, modeli ST9, kal.9X9mm, me nr. serik T1102-15AC02115.

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 364 të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa konform nenit 369 të KPP-së, gjykata përpiloi këtë aktgjykim.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti për krime të rënda,  
PKR.nr.135/22 dt. 03.04.2023.**

**Bashkëpunëtore profesionale**  
Selvane Bukleta

**Kryetari i trupit gjykues-gjyqtari**  
Shaqë Curri

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.